



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

---

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)*

Nr.1085/1Prot.

Shkodër, më 29.01.2019

**Lënda:** Jepet informacioni i kërkuar

**Rruga:** \_\_\_\_\_

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 32, datë 22. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 1085, datë 23. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2016 filloi krijimin e rrjetit të shërbimit social në komunitet, me ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare “Për Familjen”. Shërbimet me bazë komunitare janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 12 qendra komunitare; Pranë këtyre qendrave, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast si: informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë, monitorim i takimeve të fëmijëve me prindin, etj.

Në vitin 2015, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatës “Gruaja te gruaja”, kanë krijuar dhe vënë në funksion strehëzën për rastet emergjente të dhunës në familje, një shërbim i parë jo vetëm në territorin e bashkisë së Shkodrës, por në të gjithë zonën e Veriut të Shqipërisë.

Ngritja e kësaj qendre, me kapacitet prej 6 personash, ka ardhur si domosdoshmëri në përmirësimin e shërbimit ndaj të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore, pasi në të gjithë zonën e veriut të Shqipërisë, nuk ka një qendër pritëse, apo strehëz për këto raste.

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**

---